Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2024

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 03.01.2024 | Kërkesë për kryerjen e analizave të 2 rezervuarëve të ujrave të ëmbël pasi është dëmtuar peshku. Nxjerrja e shkakut të ngordhjes së peshkut. | 04.01.2024 | Pasi është kërkuar detajimi i llojve të analizave që subjekti ka kërkuar, Isuv shprehet se 2 shërbimet e kërkuara janë jashtë listës së provave/shërbimeve që ofron. | E plotë | 0 |
| 2. | 19.02.2024 | Kompania Eurofish shpk, me nr Nitpi J77520510V, me seli ne Lezhe, eshte njoftuar per prezence te «paraziteve» ne mostrat e marra nga | 26.02.2024 | Referuar kërkesës Tuaj me e-mail sqarojmë si më poshtë vijon: Përsa i përket pretendimit Tuaj lidhur me kontrollet e brendshme të HACCP , ju theksojmë se kjo nuk është detyrë dhe përgjegjësi e ISUV por e Juaj dhe AKU-së, si institucioni që kryen | E plotë | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | fabrika jone dhe te analizuara prane laboratorit tuaj.<br>Ne baze te manualit te Haccp dhe kontrollove rigoroze te vazhdueshme qe ndjekim ne cdo faze te procesit te perpunimit te peshkut, sipas manualit te HACCP, nuk na rezulton nje prezence e tille e ketij paraziti.<br>Nisur nga sa me siper, kerkojme nga ana juaj mundesine e rianalizimit te kesaj partie mall (Loti 038G) Produkt perfundimtar pasi njekohesisht na kerkohet nga kompania qe ka sjellur produktin lende e pare te rianalizoje kete produkt ne laboratore te akredituar | | kontrolle dhe kampionon. Lidhur me kërkesën tuaj për rianalizim të kampionit ,produkt perfundimtar të të njejtit Lot ju sjellim në vëmëndje se:  Laboratori ISUV i ka kryer analizat për LOT-in (Lot 038G) dhe ju ka paisur me Raport Prove. Gjithashtu ISUV ju informaon se mban përgjegjësi të plotë për kampionin që dorëzohet në Zyrën e Pritjes së Kampioneve.<br><br>Përsa më sipër ju duhet të analizoni lëndën e parë! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | jashte Shqiperise. | | | | |
| 3. | 23.04.2024 | Jam Qiro Zogo Mjek Veteriner, kam qene pjese e stafit te IKV sot ISUV ne Laboratorin Diagnostik Veterinar Gjirokaster, per peridjen 1 maj 2005 deri ne 15 korrik 2010. Nga verifikimet e kryera ne Institutin e Sigurimeve shoqerore me rezulton se per peridhen 1 maj 2005 deri ne 1 tetor 2005 emri im nuk rezulton ne listpagesa. Per kete : Kerkoj nga ana e juaj te me vini ne dispozicion Borderote ku une jam paguar nga Institucioni juaj, per ta paraqitur ne Sigurimet shoqerore per efekt | 23.04.2024 | Z.Zogo ka mar përgjigje në mënyrë shkresore lidhur me informacioni e kërkuar. | E plote | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pensioni. | | | | |
| 4. | 29.05.2024 | Ju kontaktoj nga Ambasada e Shtetit të Izraelit në Shqipëri, nën cilësinë e Këshilltarit për Ekonominë.<br><br>A ofron institucioni juaj kontroll/analizë gjethesh për mbetje substancash kundër fungusit, apo kimikate të ngjashme me matelaxyl, dimetomorph, fosetyl, alumnium, folpet, coopper, sulphur, penconazole, difenconazole?<br><br>Kërkesa vjen nga një tregtar izraelit i cili importon një sasi të madhe gjethesh nga një vreshtë në Lushnje, të cilën e shfrytëzon për | 06.06.2024 | Lidhur me kërkesën tuaj ju informojmë se ISUV nuk e ofron shërbimin e kërkuar nga ana juaj. | E plote | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | biznesin e tij (tobacco).<br><br>Më thoni si mund të koordinojmë/ veprojmë sipas mundësive. | | | | |
| 5. | 10.06.2024 | Qendra ALERT eshte nje organizate joqeveritare qe ka ne fokus te saj mbrojtjen e konsumatorit, si dhe emisionet televizive apo mediat online ne favor te informimit te konsumatoreve, me seli ne Tirane dhe e themeluar me vendim te Gjykates se Tiranes, date 17.09.2019, me Nr.1422.<br>Ne kuader te informacioneve te diteve te fundit per kontrabande apo kafshe pa dokumentacionin e duhur etj, te importuara, kerkojme nga Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise, si | 10.06.2024 | Lidhur me kërkesën tuaj ju informojmë si më poshtë vijon:<br>Sa eshte numeri i analizave jokonform ne kafshe te gjalla te cilet kane rezultuar me bruceloze , antraks dhe semundje te tjera zoonotike per vitin 2023 dhe 5 mujorin e pare te 2024?<br>Si eshte shperndarja e tyre ne Qarqe ?<br><br>ISUV te gjithe informacionin lidhur me numrin e analizave apo rasteve jokonform per semundjet Bruceloze Anthrax dhe jo vetem e raporton / percjell ne Drejtorine/Sektorin e Veterinarise/Sektorin e Epidemiologjise (EPIR) si dhe AKVMB.<br><br>Nuk eshte ne kopetencen tone komunikimi i qketyre te dhenave.<br><br>Cilat kane qene masat e ndermarra apo te propozuara nga ISUV???<br><br>Persa i perket masave te | E plote | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vijon:<br><br>Sa eshte numri i analizave jokonform ne kafshe te gjalla, qe kane rezultuar me bruceloze, antraks dhe semundje te tjera zoonitike, pergjate vitit 2023 dhe ne 5 mujorin e pare te 2024?<br><br>Si eshte shperndarja e tyre ne qarqe te ndryshme?<br><br>Cilat kane qene masat e ndermarra apo te propozuaa nga ISUV? | | ndermarra ju bej me dije se ISUV eshte pergjegjes vetem per kryerjen e analizave dhe nuk ka funksion lidhur me masa qe duhet te merren ne rastet jokonform. | | |
| 6. | 18.06.2024 | Ankese e drejtuar MBZHR-se. E deleguar ne ISUV. Z.Misim Hysenaj, i moshes 82 vjec, banues ne Yzberisht, Tirane Kerkese si me poshte vijon: Kohet e fundit me kane shqetesuar 2 artikuj gazetash po e citoj , Gazeta Telegraf e dates 14.02.2024 me titull "Shqiperia | 19.06.2024 | Ne lidhje me kerkesen Nr.3662, date 28.05.2024, drejtuar MBZHR nga shtetasi Misim Hysenaj , ISUV sqaron se:<br>Mbi problematikat qe ka ngritur qytetari, ISUV do ti ofroj ndihmesen tone mbi standartet qe operon. Konkretisht do ti ofrojme sherbim analitik vetem per produktin vaj luledielli , sipas listes se sherbimeve dhe tarifave qe kemi te miratuar.<br><br>Qytetari duhet te kete parasysh qe produkti te jete i etiketuar pasi ne ofrojme analiza vetem per | E plote | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbyte ne vaj palme dhe qumesht pluhur u blene 31 mije tone bulmet nga jashte". Artikulli i dyte i gazetes Panorama i dates 17.05.2024 me titull: "Mashtrimi , Vaji i Luledjellit, i perzier me gjembacin indian ". U shqetesova dhe erdha prane mbzhr-se ku kerkova ndihme per te bere analizat e vajit te luledjellit qe proshoj ne shtepi ku me thane te shkoja te laboratori ne kinostudio per ti bere, por atje nuk me lane policet te futja edhe njeren kembe brenda rrethimit,eshte e ndaluar rreptesisht.U indinjova shume per sjelljen e policeve. Ju lutem shume me ndihmoni per te bere te mundur analizat e vajit te luledilllit qe | | produkte te etiketuara qe tregetohen ne marketet tona. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kam me vete ne cante. Mendoj qe i jap ndihme ministris tuaj me kete rast. | | | | |
| 7. | 21.06.2024 | Pershendetje per nevoja pune te Drejtorise Vendore te Policise Berat , kerkojme ndihmen tuaj ne lidhje me nje mbetje shtazore te sekuestruar nga ana e grupit te kontollit te ushtruaer ne subjektet e therjeve te gjese gjalle konkretisht te nje mase mbetje lekure e gjetur ne subjektin me nipt L52803001V te shtetasit Agim Azizi e kontolluar nga ana jone . Nepermjet kesaj mbetje kerkojne te pecaktojme llojin e bagetise se imet . | 24.06.2024 | Lidhur me kerkesen tuaj ju informojme se ISUV nuk kryen analiza per percaktimin e llojit te kafshes ne mbetje shtazore gjate procesit te therjes. | E plote | 0 |
| 8. | 21.06.2024 | Persa i perket mostres qe kane marre me dt 05/06/2024, Flete Shoqerimi nr.163 dt 05/06/2024 per produktin | 24.06.2024 | Lidhur me kërkesën tuaj ju sqarojmë si më poshtë: Fillimisht ju bëjmë me dije se ISUV nuk bën kontestim të Raportit të Provës pasi vlerat sasiore të dala nga metodat që ne | E plote | 0 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | aciuge e kriposur me origjin Marok, Loto 06-04-2024 ne te cilen u informuam gjate inspektimit nga Inspektoret e Aku-Lezhe,qe ky produkt ka dalur me njerin nga treguesit e metaleve te renda Cadmiun (Cd) me ngarkese te larte 0.50 mg/kg .<br>Sipas raportiti te proves nr U-2894-24 dt 19/06/2024, Bazuar ne rregulloren KE 1881/06 per limitet e metaleve te renda, ku limiti eshte 0.25 per peshkun e fresket, por kjo rregullore ne nenin 3 te pikes 1,2 dhe 3 ku percakton koificentin e konvertimit per produktet qe kalojne ne transformim sic ndodh ne rastin tone qe kemi acuge te kriposur.<br>Bazuar ne rregulloren 1881/06 Neni.3 | | aplikojmë janë të pandryshueshme/instrumentale.<br>ISUV analizon dhe vlerëson vetëm rastet e kontestimit të rezultatit, të cilat janë të lidhura me alertet ose rastet jokonform.<br>Përsa më siper cituar, lidhur me Raportin e Provës me nr U-2894-24 dt 19/06/2024 i cili i përket mostrës së marrë më dt 05/06/2024, Fletë Shoqërimi nr.163 dt 05/06/2024 për produktin acuge e kriposur me origjinë Marok, Loto 06-04-2024 në të cilën u informuam gjatë inspektimit nga Inspektoret e Aku-Lezhe,që ky produkt ka dalur me njërin nga treguesit e metaleve të rënda Cadmiun (Cd) me ngarkesë të lartë 0.50 mg/kg , informojmë se ISUV nuk do të bej ndryshim të raportit të provës pasi nuk ka shpallur alert.<br><br>ISUV ka vënë në dijeni vetëm AKU dhe nuk ka bërë alert, si klienti që ka kërkuar shërbimin në kuadër të Planit me Bazë Risku .<br>Ky informacion i ka kaluar AKU-së , pikërisht për interpretimi të rezultatit dhe më pas për trajtim të rastit, si kopetencë dhe detyrë funksionale . | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pika 1,2 dhe 3 ku percakton per produktet qe i nenshtrohen nje transformimi ne kemi nje raport per vleresimin e faktorit te konvertimit per peshkun acuge te kriposura ("SSICA" Stacioni eksperimental industrise ushqimore reparti i produkteve te peshkut - Maj 2008)Ne rastin tone ku koeficienti i konvertimit per produktet e transformuara (Peshk aciuge e kriposur) eshte 0.4.<br>Me kete koeficient konvertimi sipas rezultatit qe kan dalur ne raportitin e proves<br>nr U-2894-24 dt 19/06/2024<br>0.50 mg/kg x 0.4 = 0.20 mg/kg . Keshtu qe jemi brenda normes se lejuar nga rregullorja KE 1881/06. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Prandaj kerkojme nga ana juaj qe te merret ne konsiderate shpjegimi jone bazuar ne rregulloren 1881/06 neni.3 pika 1,2 dhe 3.Duke u bazuar ne raportin e vleresimit te faktorit te konvertimit per prodhimin e aciugeve te kriposura. Bashkangjitur gjeni Raportin e vleresimit te faktorit te konvertimit per prodhimin e aciugeve te kriposura. | | | | |
| 9. | 17.07.2024 | Doja të pyesja se ku mund të gjejmë një listë të produkteve Shqiptare ( fruta perime ) që lejohen për eksport drejt vendeve të BE-se . Dhe a ka ndonje listë për produkte të cilat ndalohen nga shtete të caktuar të Be-së. Punoj për një kompani transporti ndërkombëtar | 22.07.2024 | Në vijim të kërkesës nga ana e Juaj lidhur me listën e produkteve Shqiptare ( fruta perime ) që lejohen për eksport drejt vendeve të BE-së dhe listë për produkte të cilat ndalohen nga shtete të caktuar të Be-së ju informojmë se ISUV nuk është autoriteti i cili e disponon këtë informacion. Ne ju ndihmojmë duke ju bërë me dije se autoriteti përgjegjës është Autoriteti Kombetar i Ushqimit (AKU). | E plote | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe kemi hasur probleme me eksportin e patates drejt Kroacisë. Na janë bllokuar kamioni dhe ngarkesa pasi Shteti Kroat ka thënë që duhej të kërkojmë listën pranë autoritetit tuaj. Në pritje të një përgjigje, ju uroj ditë të mbarë . | | | | |
| 10. | 22.07.2024 | Jam i interesuar të kryej analiza fiziko-kimike të kafes Por nuk kam informacjon nëse i kryeni ju si institucjon shtetëror dhe çfar detyrimesh ka ky shërbim | 22.07.2024 | Analizat qe ISUV kryen jane si me poshte vijon : Lageshti 700 lek. Permbajtja e ekstraktit ujor 400 lek. Hiri i pergjithshem 950 lek. percaktimi i pH 300lek. Cmimet jane per kampion. | E plote | 0 |
| 11. | 23.07.2024 | ot me date 23/07/2024 unjoftova mbi pergigien e marrjes se mostrave me date 12/06/2024 per analizim per Vaj Palme me nr Raport Prove U-3003-24. Ju bej me dije se ne si subje4kt e mohojme kategorikisht prodhimin he perdorimin e ketij produkti | 24.07.2024 | Ne pergjigje Tuajes, ardhur ne ISUV me date 23.07.2024, Nr. 574 Prot, ku Ju kerkoni "Rianalizim te kampionit" Ju bejme me dije se kete kerkese duhet t'ia dretoni Autoritetit Kombëtar te Ushqimit si klienti Jone ge ka sjelle kampioni. | E plote | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pasi nuk eshte pjese e praktikes dhe e produktit tone te perditshem. Ju lutem kerkojme nga ana jua edhe jehere verifikimin e produktit qe une prodhoj pasi eshte e pamundur te dalin keto pergjigje. Ne keto rethana qe ju po na vini, po na dergoni drejt mbylljes se aktivitetit pasi ne po punojme me ndershmeri dhe ju po na bini ne gafe . Kerkojme nga ana juaj marrjen e masave per kete problem dhe shetesim te ngritur ne menyre te padrejte pasi ne do ankohemi edhe me gate per kete padrejtesi qe po na ndodh. Une produktin e kam ne gendje te bllokuar dhe mund te rianalizohet perseri ose te | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | merrni masat e duhura nga ana juaj . | | | | |
| 12. | 23.7.2024 | Pershendetje, referuar pergjigjes se analizave me raport prove nr U-3002-24 date 18/07/2024 nga ana juaj per pranine e yndynave bimore une mohoj kategorikisht egzistencen e nje yndyre tjeter te perdour nga ana ime, spresoj te jete je gabim jerezor ne zingjirin e analizes dhe kerkoj me ngulm nga ana juaj dhe me pergjesi te plote verifikimin dhe rianalizimin edhe njehere te produktit te prodhuar nga ana ime pasi nuk jam dakort. Ne kemi sasi te konsiderueshme djathit dhe kacakavallit me me shume se 2 ton dhe qe jane lehtesisht te verifikueshme ne cdo GRAM produkt. | 24.07.2024 | Ne pergjigje Tuajes, ardhur ne ISUV me date 23.07.2024, Nr. 570 Prot, ku Ju kerkoni verifikimin dhe rianalizimin edhe nje here te produktit te prodhuar, Ju bëj me dije se ISUV në rastin konkret ka klient Autoritetin Kombëtar te Ushqimit dhe do kerkese ne lidhje me kampionin duhet t'ia dretoni ketij institucioni. | E plote | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kjo analize e gabuar na deton ne reputacion mbi te gjitha. Frika ime me e madhe eshte se do ket risabotim kodesh dhe kampionesh edhe ne nje analize te dyte te mundshme por nuk do ndalemi deri sa e verteta te dali ne pah. Dhe nqs do ndodhi perseri ne do bejme fare eshte e mundur ligerisht te identifikojme pergegesin duke kerkuar te drejten tone. Duke spresuar qe ka gene thjesht nje gabim jerezor dhe qe te gjindet nje zgjidhje per situaten e krijuar ju uroj pune te mbare Altin Prenga. | | | | |

Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise nuk ka kërkesa për informacion për muajin Gusht, Shtator , Tetor, Nentor, Dhjetor 2024.